

RAPORT I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2026 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1. Përmbledhje ekzekutive

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim MIE) ka miratuar 1 (një) projekt-akt, objekt të konsultimit publik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, si dhe vendimit nr. 812, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026”, konkretisht;

- Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me ligjin nr. 59/2026;

Krahasuar me vitin e kaluar ministria ka performuar mirë lidhur me këtë proces, duke diversifikuar metodat e përdorura për konsultim publik dhe duke i përzgjedhur ato në varësi të kompleksitetit të akteve.

Një problematikë që vlen të theksohet është se ka shumë vizitorë, si nga qytetarë dhe ekspertë, por janë të pakët ata që dërgojnë komente në portalin e Regjistrat Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike. Megjithatë, qytetarët/ekspertët kanë pasur mundësi dhe rrugë të tjera, si për shembull adresën e-mail për të përcjellë shqetësimet dhe sugjerimet e tyre.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i akteve për të cilin Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kryer konsultim publik gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 është 1 (një), konkretisht:

- Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

MIE ka miratuar 86 akte në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, nga të cilat 1 (një) është projektligj, 72 projektvendime, 8 urdhra dhe 5 udhëzime.

2.1.2 *Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?*

1 (një) projektligj i është nënshtruar procesit të konsultimit publik. Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuar, konkretisht 85 prej tyre, ato nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.1.3. *Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?*

Ndër projektaktet e parashikuara për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, u konsultua 1 (një) projektligj me raport të vlerësimit të ndikimit rregullator VNR.


2.1.4 *Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

Nga 27 aktet e parashikuara në Programin Analitik gjatë vitit 2026, për 17 prej tyre janë përdorur kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasi nuk janë në listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik.

Nga 18 aktet e parashikuara në PKIE, për 10 prej tyre aplikohen kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Nga 10 aktet e parashikuara në dokumentet strategjike kombëtare dhe sektoriale, për 6 prej tyre aplikohen kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Grafik 1: Përdorimi i kriterëve të përjashtimit nga konsultimi publik



2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Struktura e akteve të miratuara, këtë 6 mujor, që iu nënshtruan konsultimit publik është 1 (një) projektligj.

2.1.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

MIE vijon të zbatojë standardet e transparencës dhe pjesëmarrjes publike në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar zhvillimin e konsultimeve në mënyrë të hapur dhe gjithëpërfshirëse.

2.2 Metodat e konsultimit

2.2.1 Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik, për projektligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” ishin:

1. Nëpërmjet publikimit në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike, nga data 1 Korrik 2025 deri në 29 Korrik 2025;
2. Nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datë 1 Korrik 2025 deri në 29 Korrik 2025, të projektligjit dhe paketës shoqëruese;
3. Nëpërmjet publikimit në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike, nga data 22.4.2026-20.5.2026;
4. Nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datë 22.4.2026-20.5.2026, të projektligjit dhe paketës shoqëruese;

5. Ndërmjet postës elektronike të koordinatorit për njoftim dhe konsultim publik: vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al.
6. Njëpërmjet organizimit të tryezës së diskutimit dhe konsultimit, zhvilluar në datë 19 mars 2026, me pjesëmarrjen e palëve të interesuara në sektorin e energjisë elektrike;
7. Njëpërmjet organizimit të tryezës së diskutimit dhe konsultimit, zhvilluar në datë 8 prill 2026, me pjesëmarrjen e palëve të interesuara në sektorin e energjisë elektrike.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo njëpërmjet postës elektronike të koordinatorit për Njoftim dhe Konsultim Publik, si dhe njëpërmjet faqes së Regjistrimit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik.

2.2.3 A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, institucioni realizoi konsultim paraprak në fazat e hershme të hartimit të projektligjit, njëpërmjet publikimit në RENJKP si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të projektligjit dhe dokumentacionit shoqërues.

2.3 Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Procesi i konsultimit për projektligjin është zhvilluar gjatë vitit 2025 dhe 2026, duke ka respektuar përkatësisht afatin ligjor prej 20 ditësh pune, për publikim në RENJK, të përcaktuar në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit përsa i përket fazës paraprake dhe më pas publikimit në RENJK, është 11 muaj, 1.7.2025-20.5.2026.

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Konsultimi për projektligjin e miratuar është zhvilluar bazuar mbi parimin e pjesëmarrjes dhe proporcionalitetit, duke përzgjedhur metodat dhe targetuar aktorët që ndikohen nga politika e krijuar.

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Projektligji është hartuar nga MIE.

Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”, ka pasur 416 lexime nga qytetarët, 375 lexime nga ekspertët dhe 43 komente nëpërmjet faqes së Regjistrimit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe ëbsite i MIE.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projektligjit gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2026, pjesëmarrësit ishin:

- Ekspertë,
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë së MIE,
- përfaqësues nga aktorët e interesuar,
- përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Në procesin e konsultimit të projektligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, morën pjesë 44 përfaqësues jo-qeveritarë, kryesisht ekspertë të fushës së energjisë, ndërtimit dhe nga organizata të shoqërisë civile, si: AI EnergyX, HEC Bishnica 1,2, SPV Blue, Euron Energy, Voltalia, Nova Solar System, Sunny Side 3 nga 64 Energy, Seman Sunpower, Erseka Sol Park, 5GX Energy, HD Solar Park, Grennat SolPark Ballsh, Albpoëer, EZ-5 Energy, Ener Trade, Infotelecom Albsolar4, Gjonaj Group Holdings, Devoll Hydropower, AREA dhe FIAA, etj.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Struktura e përfaqësuesve kontribuues në konsultimet publike ishte:

1. Shoqëria Civile; Shoqata; Unione etj.
2. Organet rregullatore,
3. Insitucionet e varësisë së ministrisë.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata për gjashtëmujorin e parë 2026 paraqitet e njëjtë me vitin e kaluar. Procesi i konsultimit ka qenë proaktiv dhe gjithëpërfshirës, duke zhvilluar konsultime të fazuara duke mundësuar kështu pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesit.

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në regjistrin e konsultimeve publike si dhe nëpërmjet postës elektronike janë regjistruar 43 komente/sugjerime nga aktorët e interesuar.


2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Për projektligjin e konsultuar dhe të miratuar gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2026, numri total i komenteve të përcjella ka qenë 43, prej të cilave:

- 3 të pranuar plotësisht;
- 11 të pranuar pjesërisht;
- 29 të refuzuara, nga të cilat:

1. (9) refuzuar, pasi komenti lidhej me ndërhyrje jashtë objektit të projekt aktit.
2. (0) refuzuar, pasi komenti lidhet me ndërhyrje jashtë kompetencës së institucioneve të qeverisjes qendrore.
3. (15) refuzuar, pasi komenti gjen zgjidhje në një projekt akt tjetër ligjor/nënligjor.
4. (5) refuzuar, pasi komenti bie ndesh me procedurat/afatet e ndjekura nga institucionet e Bashkimit European në kuadër të Acquis që po transpozohet.

Grafik 2



2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Konstatohet se nuk ka ndonjë ndryshim domethënës në krahasim me vitin e kaluar.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Ka pasur një raport të vlerësimit të ndikimit rregullator VNR për projektligjin e konsultuar, i cili është përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik.

2.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2026, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka publikuar 1 (një) raport individual konsultimi, për projektligjin e miratuar.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk ka raporte të pa publikuara.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

MIE vlerëson se procesi i konsultimit publik për projektligjin është zhvilluar në përputhje me kërkesat e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, duke garantuar transparencën, aksesin në informacion dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

3. **Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Për sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik mund të përmendim përfshirjen e publikut, ndërmjet një angazhimi më të madh në këtë proces. Me qëllim përmirësimit të procesit të konsultimit publik, sugjerohet organizimi i konsultimeve përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik.